



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 10/11

Prishtinë, më 20.04.2011, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Avni Mazreku dhe Dritan Gjonbalaj-AAC, Ali Hamiti-ZRRE, Enis Berisha-ARRH, Lavdim Krasniqi-IGJK, Ramadan Islami, Teki Shala dhe Njomza Ilazi nga GIZ si dhe monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI dhe USAID.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Autoritetit të Aviacionit Civil, I ftuar: Driton Gjonbalaj, Drejtor i përgjithshëm i AAC;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Zyrës së Rregullatorit për Energji, I ftuar: Ali Hamiti, Kryesues i Bordit të ZRRE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, I ftuar: Halit Gara, Kryesues i Bordit të ARRH-së;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Institutit Gjyqësor të Kosovës, I ftuar: Lavdim Krasniqi, Drejtor i IGJK-së;**
- 6 . Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.

Rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2010

Kryetrajja, tregoi që raporti në përgjithësi i përfshin të gjitha ato elemente që i kërkon ligji. AAC-ja në vetëfinancohet, përmes taksave dhe licencimeve siq i parasheh ligji përkatës dhe në pajtim me nga të Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Gjithashtu ky Autoritet ka pasur edhe donacione dhe grante. Në raport shihet mjetet 333.456 €, të cilat i ka menaxhuar UNMIK-u dhe mëpastaj AAC-ja, është kërkuar të përdoren për ndërtimin e një objekti i cili nuk është realizuar, lidhur me këtë kërkoj sqarim për këtë shumë se a është përfshirë në kuadër të të hyrave të AAC-së apo janë të hyra të veçanta. Po ashtu nëse AAC-ja i ka inkasuar të gjitha të hyrat e planifikuara përmes tarifave të caktuara?

Avni Mazreku, prezentoj shkurtimisht raportin duke thënë që në bazë të raportit të progresit për parametrat bazë, AAC-ja ka qenë një nga institucionet model duke shënuar progres të theksuar. Pikëpamja e Bordit Mbikëqyrës të AAC-së është mjaft pozitiv, sa i përket mbikëqyrjes së shpenzimeve të AAC-së.

Dritan Gjonbalaj, duke iu referua çështjes së mjeteve të mbetura nga fondet e Zyrës Rregullatore të Aviacionit Civil, njoftoi se këto mjete kanë shkuar në organizatën ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe janë menaxhuar nga UNMIK-u, por që kanë qenë mjete të Buxhetit të Kosovës. Pas themelimit të AAC-së dhe transferimit të kompetencave, këto mjete janë kthyer në Buxhetin e Kosovës si të hyra të dedikuara të AAC-së. Sa i përket të hyrave, tregoi që ekziston vetëm një burim i të hyrave të AAC-së që është tarifa e sigurisë së pasagjerëve e cila vihet për secilin udhëtar që udhëton në fluturime komerciale në Aeroportin e Prishtinës. Të hyrat për vitin e kaluar kanë qenë të planifikuara rreth 1 milion €, por janë realizuar më tepër se që është planifikuar të cilat varen nga numri i udhëtarëve që në këtë vit ka qenë më i madh. Një çështje tjetër me rëndësi që e përmendi ishte edhe çështja e pagave të punëtorëve të AAC-së, të cilët paguheshin me një skemë të veçantë të pagave, të cilat janë prej 350€ - 1903€.

Kryetarja, kërkoj sqarim edhe për ato dy format tjera që shërbejnë si burim i financimit, por që nuk realizohen?

Sali Asllanaj, vlerësoi përgatitjen teknike të raportit. Shprehu shqetësim të përgjithshëm se të gjitha agjencionet e pavarura janë me qira dhe propozoi që komisioni të bën apel që të gjendet një zgjidhje për këto agjencione, në mënyrë që të ketë alternativa që ato mjete të qirasë të shpenzohen për ndonjë investim kapital.

Xhevdet Neziraj, vlerësoi të rëndësishme që raporti i auditimit të vijë në komision për të parë se a qëndrojnë me të vërtetë këto pozicione kështu si janë paraqitur në raport. Kërkoj sqarim për mallra dhe shërbime, me ç'rast në një pozicion paraqiten furnizimet me ushqim dhe pije dhe në një tjetër shpenzime të reprezentacionit, pyeti se a bën që këto të futen në një vend, apo janë ndarë me qëllim? Gjithashtu kërkoj arsyetim për kategorinë e furnizimeve për zyre që është paraqitur një shumë prej 58.000 €, dhe për pozitën e juristit të AAC-së, pyeti se a është jurist i specializuar për aviacion apo është një drejtim i ri?

Duda Balje, pyeti se si planifikoni të realizoni të ardhura për investime kapitale dhe për çka do të shpenzohen ato mjete?

Hasime Krasniqi, sa i përket të hyrave të siguruar nga tarifat e sigurisë së pasagjerëve, e cila është 2 € për person, nëse llogaritet kjo me numrin e udhëtarëve në vitin 2010, prej 1.305.532, kur shumëzohet me tarifën prej 2 €, atëherë nuk del shuma e të hyrave që janë paraqitur në raport, për këtë kërkoi një sqarim? Pyeti edhe për format e tenderimit të prokurimit publik, se a bëhet me tender ta hapur, me negociata, pa negociata apo me kontrata?

Dritan Gjonbalaj, sqaroi se dy format tjera të financimit që nuk përdoren është për arsye se, një pjesë e tarifës për mbikalimet që do duhej t'i merrte Kosova nga aeroplanët që fluturojnë në hapësirë të lartë ajrore të Kosovës, e cila për momentin është e mbyllur për mbifluturime dhe nuk mund të realizohen të hyra nga kjo tarifë e mbikalimeve. Tarifa tjetër është ajo për licencim dhe certifikim, të cilat AAC-ja i ka bërë pa pagesë, duke përfshirë certifikimin e ANP-së. Sa i përket çështjes së qirasë, ai theksoi që janë bërë kërkesa të vazhdueshme tek institucionet e shtetit për të gjetur një objekt shtetëror. Kategoria e furnizimeve me ushqim dhe pije, sqaroi se ka të bëjë me shpenzimet që bëhen për kafe, çaj dhe ujë për personelin e AAC-së, ndërsa shpenzimet e reprezentacionit kanë të bëjnë përveç drekave dhe darkave për mysafirët. Furnizimet për zyre kanë të bëjnë më atë se gjatë vitit të kaluar AAC-ja ka kaluar në një objekt më të madh dhe kanë qenë të nevojshme të blihen mobile dhe pajisje tjera. Sa i përket investimeve kapitale tregoi që është një plan për ndërtimin e objektit të AAC-së. Të hyrat nga tarifa e sigurisë së pasagjerëve, merret vetëm nga udhëtarët që nisen nga ANP-ja. Procedurat e tenderimit zhvillohen në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2010.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Zyrës Rregullative për Energji

Kryetarja, theksoi që raporti në përgjithësi i përfshin elementet kryesore që i parasheh Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe nga raporti shihet se gati në të gjitha kategoritë ekonomike ka pasur një lloj suficit. Raporti nuk përfshin paraqitjen e të hyrave në bazë të asaj se sa janë planifikuar që të inkasohen dhe sa janë realizuar në raport me ato që janë planifikuar.

Ali Hamiti, sqaroi se të hyrat nuk janë paraqitur në detale, pasi që të hyrat e ZRRE-së, janë shumë të specifikuar. Sipas ligjit, ZRRE financohet nga të hyrat vetanake të cilat mbledhen nga të licencuarit përmes tarifave të përcaktuara. Ai tregoi që nuk janë shpenzuar të gjitha të hyrat si rezultat i punës së mirë dhe kursimeve si dhe realizimit më të madhë të të hyrave se sa janë planifikuar.

Hasime Krasniqi, pyeti lidhur me vendimin e Bordit që është marrë më datën 30 prill 2010 kur është bërë lirimi gjatë licencimit të rregullatorëve, kush është përfitues i periudhës prill-tetor, dhe pse është marrë vendimi pasi që është siguruar buxheti dhe është ndërprerë? Shifet se është bërë një planifikim jo i mirëfilltë i buxhetit me ç'rast është shpenzuar vetëm 76.5 % e buxhetit dhe arsyeja nuk qëndron te kursimet, por në planifikimin jo të mirëfilltë të punës. Gjithashtu theksoi se është dashur të bëhet një krahasim i të hyrave prej vitit në vit.

Ali Hamiti, sqaroi se përfitues është qytetari, pasi që ZRRE-ja nuk i merr ato mjete nga KEK-u dhe i llogaritet si të hyra të tepruara që i kanë në dispozicion. Mirëpo kjo shumë është e vogël dhe nuk ka

mundur që të ndikojë në rritjen e tarifave, por këto mjete i kthehen konsumatorit përmes tarifave me ç'rast nuk rritet tarifa për aq.

Hykmete Bajrami, theksoi që disa qytetarë e paguajnë rrymën dy herë, një herë përmes faturës së rrymës dhe herën tjetër me taksat. prej të cilave ndahet buxheti për KEK-un, lidhur me këtë pyeti se sa është e drejtë kjo dhe çka ka bërë ZRRE-ja për ta rregulluar këtë çështje? Sipas saj çmimi i energjisë elektrike është shumë i shtrenjtë, me të cilin çmim KEK-u dhe operatorët rregullues po mundohet të mbulojë keqmenaxhimin e tyre, dhe pyeti se çka është duke u ndërmarrë kjo zyre në këtë aspekt? Lidhur me raportin financiar, u interesua të dinte për numrin e punëtorëve dhe skemën e pagave të këtyre punëtorëve. Gjithashtu kërkoi sqarim për kategorinë e anëtarësimit në vlerë prej 6.400 €.

Muhamet Mustafa, sugjeroi që t'i kushtohet vëmendje më e madhe cilësisë së energjisë dhe mënyrës së faturimit, sepse ka ankesa që në rastet kur KEK-u ka nevojë për mjete i frynë faturat e qytetarëve. Pyeti sa janë çmimet e konsumit të energjisë në raport me rajonin?

Ali Hamiti, iu përgjigj se janë të paraparë 33 punëtorë, mirëpo të punësuar janë 27, gjithashtu Bordi është vetëm me tre anëtarë, sepse dy prej tyre u ka kaluar mandati. Lidhur me çmimin e energjisë, është një prej çmimeve më të ulëta në regjion, sepse Qeveria jep subvencione për import të energjisë. Sa i përket cilësisë së energjisë tregoi që nuk mund të sigurohet tension i cilësisë së lartë, sepse ka nevojë për investime të mëdha, e që kjo do të ndikonte në rritjen e tarifave më ç'rast do të ngarkoheshin drejtpërdrejtë konsumatorët.

Kryetarja, shprehu shqetësimin në emër të komisionit, që ZRRE-ja për vitin 2011 nuk ka paraqitur fare kërkesë buxhetore dhe për mënyrën se si është bërë detalizimi i buxhetit. Sugjeroi që në të ardhmen të bëhet detalizimi i të hyrave dhe shpenzimeve në raport.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë raportin vjetor financiar të Zyrës Rregullative të Energjisë për vitin 2010.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

Kryetarja, tregoi që nga raporti përmban një pasqyrë të përmbledhur për shpenzimet, megjithatë buxheti nuk është shpenzuar ashtu siç është planifikuar.

Enis Berisha, e arsyetoi mos realizimin e buxhetit ashtu siç është planifikuar, për shkak se ARRH-ja ka filluar aktivitetin nga muaji prill i vitin 2010, ndërsa Bordi ka filluar nga muaji gusht 2010. Në vazhdim ai prezantoi shkurtimisht pjesën financiare të raportit i cili prezantuar edhe me shkrim.

Hykmete Bajrami, theksoi se është dashur të kemi një pasqyrë më të detalizuar të shpenzimeve për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, e cila përshinë një shifër shumë të madhe?

Zyrtari financiar, sqaroi se shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë të bëjnë me shpenzimet për furnizime me materiale librare, pagesat për pjesëmarrjen e trajnimeve, shpenzimet për karburantet e veturave.

Kryetaria, në pyetjen e znj. Bajrami, njoftoi se autoriteti në fjalë ka dorëzuar pasqyrën e detalizuar për mallra dhe shërbime, e cila do t'u postohet të gjithë anëtarëve të komisionit. Lidhur me këtë, kryetaria theksoi që në raport po evidentohet shuma në vlerë prej 77 mijë e 914 €, kurse është paraqitur 76 mijë e 13 €, pse nuk po përputhen këto vlera?

Sali Asllanaj, për shkak të vërejtjeve për raportin jo i kompletuar, sugjeroi që herën tjetër të vijë një raport më i kompletuar me shpenzime të detalizuara.

Xhevdet Neziraj, përkujtoi që Drejtori i Bordit kur është bërë planifikimi buxhetor ka kërkuar shumë më tepër, ndërsa tani nga raporti po del që nuk është realizuar as 40 %.

Zyrtari financiar, në pyetje e Kryetares, shpjegoi se shuma e mospërputhjes është për shkak të barazimeve me sistemin free balance. Sa i përket mosrealizimit të buxhetit, kjo ka ndodhur për shkak të fillimit të aktivitetit të vonshëm të autoritetit dhe mosrekrutimit të stafit.

Kryetaria konstatoi se Komisioni me nëntë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Duda Balje, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Latif Gashi dhe Muhamet Mustafa) një abstenim (Hykmete Bajrami) dhe asnjë Kundër, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandohet Kuvendit, të raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2010.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Instituti Gjyqësor të Kosovës

Kryetaria, tregoi që në raport janë paraqitur të detalizuara të gjitha kategoritë e shpenzimeve, ku vërehet që pjesa më e madhe e mjeteve është shpenzuar për qira dhe për sigurim të ndërtesave dhe vërehet që ka pasur një suficit. Për këtë kërkoi sqarime nga përfaqësuesit e IGJK-së, kur dihet se kërkesa e këtij instituti në këtë kategori në planifikimet buxhetore ishte e madhe.

Lavdim Krasniqi, theksoi që shpenzimet më të mëdha kanë qenë për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, sepse ka pasur aktivitete arsimore ligjore, gjithashtu edhe shpenzimet e qirasë që janë më të mëdha. Lidhur me pjesën e pa shfrytëzuar të buxhetit tregoi që ato mjete janë kthyer në buxhet, pasi që një pjesë e madhe e mjeteve është siguruar nga donatorët.

Kryetaria, sugjeroi që në raport të paraqitet edhe një kolonë për të pasqyruar se si ka qenë planifikimi i buxhetit dhe sa është realizuar, sepse kjo do ta ndihmojë komisionin për një planifikim më të mirë.

Sali Asllanaj, pyeti se a do ta ketë IGJK-ja ende mbështetjen e donatorëve dhe çka do të bëhet me ato shkurtesat buxhetore?

Lavdim Krasniqi, tregoi që donatorët kanë premtuar mbështetje, por sa do të realizohet ajo nuk është e sigurt. Viti 2011 është vit i sfidave më të mëdha për IGJK-në, pasi që u është ngarkuar obligimi për përgatitjen e të gjithë kandidatëve për prokurorë e gjyqtarë, që do t'i plotësojnë pozitat e mbetura pas emërimit dhe riemërimit. Nëse nuk arrihet që të sigurohen mjete shtesë, atëherë duhet që të ndërpriten aktivitete tjera në mënyrë që të plotësohet ky program pasi që është prioritet. Kjo çështje besoj që do të rregullohet me rishikim të buxhetit dhe me ndihmën e donatorëve.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë raportin vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2010.

6. Të ndryshme

6.1 Kryetarja njoftoi anëtarët për takimin që është planifikuar dhe organizuar nga GIZ, në bashkëpunim me Komisionit dhe do të mbahet më datën 26 prill 2011, prej ora 9:00 deri në 14:00 në restorantin “Villa Panorama”, në Prishtinë. Agjenda iu është shpërndarë dhe do të bisedohet për prezantimin e projekteve të përbashkëta të GIZ me komisionin.

6.2. Kryetarja njoftoi anëtarët për ftesën që ka bërë Komisionit të Pavarur për Media për një takim pune në Ohër, i cili do të mbahet nga data 21-24 prill 2011, ku janë ftuar përveç kryetarit të komisionit edhe dy anëtarë tjerë të këtij komisionit. Në këtë takim do të prezantohen objektivat dhe planet e veprimit të KPM-së si dhe do të diskutohen financimi i KPM-së.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni vendosi që në këtë takim pune të marrin pjesë këtë anëtarë:

1. Latif Gashi
2. Sali Asllanaj dhe
3. Albana Fetoshi

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Safete HADËRGJONAJ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

IV Saziv

Komisija za budžet i financije

Sednica br. 10/11

Priština, 20.04.2011, u 13:00 časova

Zgrada Skupštine, sala C-203

Z A P I S N I K

Sednici su prisustvovali: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Aslanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa i Duda Bale.

Ostali Prisutni: Avni Mazreku i Driton Gjonbalaj AAC, Ali Hamti – ZRE, Enis Berisha – ARRH, Lavdim Krasniqi IGJK, Ramadan Islami, Teki Shala i Njomza Iljazi iz GIZ-a i monitori iz Ureda Presidenta, OEBS-a, KDI-a, i USAID –a

Osoblje za podršku komisiji: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli i Aurora Ademi (pripravnica).

Sednicu je predsedavala Safete Hadergjonaj, predsednica Komisije i predložila je ovaj;

D n e v n i r e d

- 1, Usvajanje Dnevnog reda,
2. Razmatranje godišnjeg finansijskog izveštaja autoriteta civilne avijacije za 2010.god., pozvani Driton Gjonbalaj, generalni direktor ACA.
3. Razmatranje godišnjeg finansijskog izveštaja Kancelarije Regulatora za energetiku za 2010.god., pozvan Ali Hamiti, predsednik Borda.
4. Razmatranje godišnjeg finansijskog izveštaja Regulativnog autoriteta železnica za 2010.god., pozvan Halit Gara, predsednik Borda.
5. Razmatranje godišnjeg finansijskog izveštaja Pravosudnog instituta Kosova za 2010.god., pozvan Lavdim Krasniqi, direktor.
6. R a z n o

1. Usvajanje Dnevnog reda

Predsednica – je otvorila sednicu i predložila dnevni red koji je usvojen bez prijedbi.

2. Razmatranje godišnjeg finansijskog izveštaja autoriteta civilne avijacije za 2010.god., pozvani Driton Gjonbalaj, generalni direktor ACA

Predsednica – je istakla da Izveštaj u celini sadrži potrebne elemente zahtevane zakonom.

ACA se samo financira, taksama, licencijama kao što predviđa dotični zakon u skladu sa Zakonom za menadžiranje javnih financija. Oni su isto tako imali donacija i grantove. Iz izveštaja se vidi da sredstva u iznosu od 333.456 € koje je menadžirao UNMIK, a po tom je zahtevano da AAC koristi za izgradnju objekta koji nije realizovan, u vezi toga je zahtevala objašnjenje da li je taj iznos uključen u prihodima ACA ili su poseban prihod. Isto tako da li je ACA inkasirala sve planirane prihode putem određenih tarifa.

Avni Mazreku – je ukratko prezentirao Izveštaj istaknuvši da na osnovu Izveštaja progressa za osnovne parametre, ACA je institucija model za istaknuti progres. Nazor Borda Nadzora ACA-e je veoma pozitivan u odnosu na nadzor troškova ACA.

Dritan Gjonbalaj – odgovarajući na pitanju u vezi preostalih sredstava iz fondova Kancelarije Regulatora civilne avijacije, on je istakao da se ta sredstva otišla u međunarodnoj organizaciji civilne avijacije i menadžirana su od UNMIK-a, ali bila su sredstva budžeta Kosova. Nakon usvajanja ACA, i transfera nadležnosti ta sredstva su vraćena budžetu Kosova sa prihodom namenjenim ACA-e. Što se tiče prihoda on je rekao da postoji samo jedan izvor a to je tarifa sigurnosti putnika koja se plaća za svakog putnika koji putuje iz Prištinskog aerodroma. Prihodi za prošlu godinu su bili planirani oko milion evra ali je realizovano više od planiranog s obzirom da je broj putnika bio veći. Drugo značajno pitanje što je navedeno je i pitanje plata radnika ACA. Oni se plaćaju od 350 do 1903 €.

Predsednica – je zahtevalo objašnjenje o ostale dve forme izvora financija koje se ne realizuju.

Sali Asllanaj – je izrazio opštu uznemirenost za sve nezavisne agencije koje su smeštene u objektima pod zakupom i predložio je da Komisija nađe rešenje kako bi bilo alternativa da sredstva za plaćanje zakupa ulažu u kapitalne investicije.

Xhevdet Neziraj - je istakao veoma značajnim da Izveštaj revizije dođe u Komisiji kako bi videli da li su takve zaista te pozicije onako kao što su prezentovane u Izveštaju. On je tražio objašnjenja za robe i usluge, u jednom pložaju se predstavljaju troškovi snabdevanja hranom i napitcima a u drugom se predstavljaju troškovi reprezentacije, i pitao je da li je moguće da se ti troškovi objedine u prikazivanju ili su namerno odvojeni?

On je isto tako tražio obrazloženje o kategoriji snabdevanja za kancelarije u iznosu od 58.000 € i o položaju pravnika ACA i pitao: Da li je specijalizovani pravnik za avijaciju ili je to novi smer?

Duda Balje – pitala je, kako planirate da realizirate prihode za kapitalne investicije i gde ćete potrošiti ta sredstva?

Hasime Krasniqi – štop se tiče prihoda obezbeđenog od tarifa osiguranja putnika koja je 2 € po putniku, ako se to obračuna na osnovu putnika za 2010. god. Broj putnika iznosi 1.305.532 i kada se umnoži sa 2 ne dobijemo iznos koji je predstavljen u Izveštaju, i zahtevala je objašnjenja o tome ali pitala i o formama tendera javnih nabavki, da li su tenderi otvoreni, sa pregovorima ili bez pregovora ili sa ugovorima?

Dritan Gjonbalaj - je objasnio da oba ostala načina financiranja ne upotrebljavaju jer deo tarife nadleta koje treba da dobije Kosovo od visokog nadletanja vazdušnog prostora Kosova, koje trenutno zatvoreno za nadgledanja, ne mogu se realizovati. Druga tarifa je ona za licencovanje i sertifikovanje, koje je ACA do sada izvršila besplatno uključujući i licenciranje međunarodnog Aerodroma Priština. Što se tiče zakupa on je istakao da su imali stalne zahteve kod državnih institucija za pronalaženje državnog objekta. Što se tiče kategorije snabdevanjem hranom i napitcima, on je objasnio da se odnose na troškove, za kafu, čaj i vodu za osoblje ACA dok troškovi reprezentacije odnose se na troškove ručkove i večera za goste. Kancelijsko snabdevanje odnosi se na prošlu godinu kada je ACA prošla u veći objekat i bilo je potrebno da se snabdevamo nameštajem i ostalom opremom za kancelarije. Što se tiče kapitalnih investicija on je istakao da je planirana izgradnja objekta ACA. Prihodi iz osigurnaja putnika, uzimaju se samo za putnike koji odlaze sa Prištinskog Aerodroma. Procedure tenderisanja se odvijaju na osnovu zakona o javnim nabavkama.

Predsednica – je konstatovala da je Komisija jednoglasno donela ovu:

P r e p o r u k u

I. Preporučuje se Skupštini Kosova da usvaja godišnji finansijski izveštaj Autoriteta civilne avijacije za 2010. godine.

3. Razmatranje godišnjeg finansijskog izveštaja Kancelarije Regulatora za energetiku za 2010.god. pozvan Ali Hamiti, predsednik Borda

Predsednica – je istakla da Izveštaj sadrži glavne elemente predviđene Zakonom o menadžiranju javnih financija i odgovornostima, iz istog se vidi da skoro u svim ekonomskim kategorijama ima neku vrstu suficita. Izveštaj ne obuhvaća prikazivanje osnovnih prihoda koji su planirani da se inkasiraju i koliko je realizovano u odnosu na planirano.

Hasime Krasniqi – u vezi odluke borda od 30 aprila 2010 kada je izvršen popust u toku licencovanja regulatora, koji je u dobiti tu u periodu april – oktobar i zašto je doneta odluka s obzirom da je obezbeđen budžet i da je prekinuto? Vidi se da je planirano bilo ne ispravno i da je potrošeno samo 76.5 % budžeta, i razlog nije kod štednje nego kod neispravnog planiranja. Isto tako je istakla da se treba izvršiti upotređenje prihoda od godine na godinu.

Ali Hamiti – je objasnio da korist od toga imaju svi građani s obzirom da KRE ta sredstva ne uzima od KEK-a i računa ih kao suvišna sredstva koje imaju na raspolaganje. Ovaj iznos je veoma mali i nije bilo moguće da utiče na povećanje tarife nego ta sredstva se vraćaju potrošaču putem tarifa koja se ne povećaju za toliko.

Hykmete Bajrami – je istakla da neki građani struju plaćaju 2 puta, 1 put putem računa za potrošenu struju a drugi puta taksama, od kojih se odvaja budžet za KEK, u vezi toga je ona pitala koliko je to ispravno i šta je KRE preduzelo za uje tog pitanja. Prema njoj, cena električne energije je veoma visoka čime KEK i operatori regulisanja nastoje da pokriju loše menadžiranje. Međuvremeno je pitala šta je preduzeto od te kancelarije u odnosu na to? U vezi finansijskog izveštaja ona je htela da zna o broju radnika i šemu njihovih plata. Isto tako je tražilo objašnjenje o kategoriji učlanjenja u iznosu do 6.400 €.

Muhamet Mustafa – je preporučio da se veća pažnja posveti snabdevanju građana strujom i načinu fakturisanja jer ima žalbi da u slučaju kada KEK ima potrebu za dodatna sredstva, naduva fakture građanima. I pitao je koje su cene potrošnje energije u odnosu sa regijom.

Ali Hamiti – sve ukupno je predviđeno 33 a zaposleno je 27 radnika, Bord ima samo 3 člana jer dvojici od njih je istekao mandat. U vezi cene, on kaže da su najniže u regiji jer Vlada subvencionira uvoz energije. Što se tiče kvalitete on je rekao da ne postoji mogućnost dobre kvalitete jer ima potrebe za velike investicije, što bi uticalo na povećanje tarifa i time bi potrošači bili direktno preopterećeni.

Predsednica – je izrazila zabrinutost u ime Komisije da KRE za 2011 godinu nije podneo zahtev za budžet i o načinu detalizacije budžeta. Ona je sugerisala da u buduće detaliziraju u Izveštaju prihodi i rashodi.

Predsedica je konstatovala da Komisija jednoglasno donela ovu:

P r e p o r u k u

- I. Preporučuje se Skupštini da usvaja godišnji izveštaj Kancelarije regulatora energije za 2010. godinu.

4. Razmatranje godišnjeg finansijskog izveštaja Regulativnog autoriteta železnica za 2010.god., pozvan Halit Gara, predsednik Borda

Predsednica – je istakla da Izveštaj sadrži sažeti pregled troškova, ali ipak budžet nije potrošen onako kako što je planiran.

Enis Berisha – je obrazložio time da je budžet planiran tako s obzirom da RAŽ je počeo svoju aktivnost aprila 2010 dok je bord avgusta 2010. U nastavku on je u kratko prezentovao finansijski deo pisanog izveštaja.

Hykmete Bajrami – je istakla da se morali imati detaljni pregled troškova za kategoriju robe i usluge, koja obuhvaća izuzetno visoki iznos.

Zvaničnik za financije je objasnio jer troškovi za robe i usluge odnosi se na snabdevanje kancelarijskim materijalom, plaćanje učešća na obučavanja i troškovi za goriva vozila.

Predsednica – na pitanje g-đa Bajrami je informisala da su isti predali detaljni pregled za robe i usluge koja će biti dostavljena svim članovima Komisije. U vezi toga Predsednica je istakla da će se u izveštaju evidentirati iznos od 77.914 € dok je ovde predstavljeno 76.013 €, zašto se ne slažu i iznosi.

Sali Asllanaj – zbog primedbi o nekompletnom izveštaju on je rekao da će narednih puta doći sa izveštajem koji će biti kompletiran i sa detaljnim troškovima.

Xhevdet Neziraj – je potesetio da direktor borda kada je izvršeno planiranje budžeta tražio više sredstava a iz Izveštaja ispada da nije realizovano ni 40% sredstava.

Zvaničnik za financije – na pitanje predsednice je rekao da neusklađivanje tog odnosa je zbog poravnanja sa sistemom free balans. Što se tiče nerealizovanje budžeta to se desilo zbog zakašnjelog početka aktivnosti autoriteta i ne regrutovanja osoblja.

Predsednica je konstatovala da je komisija usvojila izveštaj sa jednim uzdržanim glasom (Hykmete Bajrami) i donela je ovaj:

P r e p o r u k u

- I. Preporučuje se Skupštini da usvaja godišnji izveštaj Kancelarije regulatora železnica za 2010. godionu.

5. Razmatranje godišnjeg finansijskog izveštaja Pravosudnog instituta Kosova za 2010.god., pozvan Lavdim Krasniqi, direktor

Predsednica – je istakla da su u izveštaju detaljno predstavljene sve kategorije troškova gde se primećuje da najveći deo sredstava je potrošeno za zakup i za obezbeđenje objekata i primećuje se da je bilo i suficita. O tome je zahtevala objašnjenja, kada se zna da zahtev ovog instituta za ovu kategoriju u budžetskom planiranju je bio mnogo veći.

Lavdim Krasniqi – je istakao da su troškovi za kategorije roba i usluga bili veliki jer je bilo obrazložno pravnih aktivnosti i troškovi z akupa su visoki. U vezi potrošnje budžeta koji nije potrošen on je rekao da su ta sredstva vraćana budžetu s obzirom da veliki deo sredstava je obezbeđeno od donatora.

Predsednica – je preporučila da se u izveštaju upiše još jedna kolona za predstavljanje planiranog i realizovanog budžeta, jer će to pomoći komisiji za bolje planiranje.

Sali Asllanaj – je pitao da li će institut imati i dalje podršku donatora i šta će biti sa budžetskim uskraćivanjima?

Lavdim Krasniqi – je rekao da su donatori obećali podršku ali koliko će se realizovati nije sigurno. 2011 godina je godina velikih izazova za ovaj institut s obzirom da ima obavezu za pripremu svih kandidata za tužioce i sudije koji će popuniti sve položaje nakon imenovanja i ponovnog imenovanja. Ako se ne uspevaju osiguravati dodatna sredstva, onda moraju se prekinuti ostale aktivnosti kako bi se realizovao ovaj program koji je od prioriteta. Ja mislim da će se to rešiti rebalansom budžeta i uz pomoć donatora.

Predsedica je konstatovala da Komisija jednoglasno donela ovu:

P r e p o r u k u

Preporučuje se Skupštini da usvaja godišnji izveštaj Pravosudnog instituta Kosova. za 2010. godinu.

6. R a z n o

Predsednica je informisala prisutne članove komisije da planirani i organizovani susret od GIZ-a u sradnji sa Komisijom će se održavati 26. aprila 2011 od 9:00 do 14:00 u restoranu (Vila Panorama“ u Prištini, agenda je vam podeljena i tamo ćemo raspravljati o prezentovanju zajedničkih projekata GIZ-a i Komisije.

Predsednica je informisala članove komisije o pozivu Nezavisne Komisije za medije o radnom susretu u Ohridu od 21 – 24 aprila 2011 gde su pozvani uz predsednicu Komisije još dva člana. U ovom susretu prezentovaće se objektivni i plan delovanja NKM-a kao i finansiranje iste.

Nakon susreta i predloga Komisija je odlučila da u ovom radnom susretu učestvuju i ovi članovi:

1. Latif Gashi,
2. Sali Asllanaj,
3. Albana Fetoshi.

Sednica je završena u 15:00 časova

Zapisnik je sastavila:

Jedinica za podršku Komisiji

Predsednica Komisije
Safete Hadergjonaj